



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002446/4

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin të procedurave të pranimit dhe akomodimin e familjareve të azilkërkuesve në Shqipëri.*

Drejtuar: znj. Elena PICI
Sekretar i Përgjithshëm
MINISTRIA E BREMDSHME

TIRANË

Për dijëni: z. Ermir ALIÇKA
Drejtor
Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuesve Babrru

TIRANË

Të nderuar,

Sikurse ju kemi vënë në dijeni me shkresën K4/I17-2 prot, datë 22.04.2020, institucioni i Avokati të Popullit ka filluar me iniciativë rastin e bërë publik në media nga azilantët në Shqipëri¹. Ata ngritën para mediave disa pretendime ndaj Qendrës Kombëtare të Pritjes për Azilkërkuesit, Babrru. Konkretisht për shkelje të procedurave standarde dhe të rregullave që normojnë veprimtarinë e këtij organi për akomodimin e 10 persona në një dhomë pa asnjë kusht. Sipas tyre, në Qendër mungojnë shërbimet bazë, ndaj janë detyruar të dalin jashtë saj. Ata kërkojnë vëmendje të veçantë nga institucionet e shtetit shqiptar për respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre, në bazë të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në mbrojtje të të drejtave të njeriut, me fokus azilkërkuesit.

Gjithashtu, ata janë shprehur se nuk kanë bërë asnjë test të Covid-19 dhe nuk janë testuar prej 10 ditësh që ndodhen në Tiranë.

¹"Ora News.tv", <https://www.youtube.com/watch?v=KUWXGI8fZJw>

Në lidhje me sa më sipër i jemi drejtuar me shkresën K4/I17-2 prot, datë 22.04.2020 Qendrës Kombëtare të Pritjes për Azilkërkuesve, Babrru Tiranë, për shpjegime lidhur me pretendimet e azilkërkuesve.

QKPA Babrru, Tiranë me shkresën nr.118/1 prot, datë 30.04.2020 na informoi ndër të tjera se gjatë periudhës Janar – Mars të vitit 2020, janë akomoduar një numër i madh azilkërkuesish. Konkretisht gjatë kësaj periudhe janë akomoduar 2409 azilkërkues. Gjithashtu, në Qendër numëri i personave të akomoduar në ditë ka qenë shumë i lartë. Për situatën e krijuar është bërë me dije në rrugë elektronike Drejtoria e Azilit të Shtetësisë për marrjen e masave të mëtejshme pasi Qendra ndodhet mbi kapacitetin akomodues e cila është 180 shtretër. Qendëra Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuesit, Babrru Tiranë, gjatë kësaj periudhe ka akomoduar një numër të lartë familjesh, 265 familje, ku përbërja e tyre ishte 3(tre) deri në 10 (dhjetë) persona. Apartamentet janë parashikuar për t'u akomoduar 3-4 persona. Familjet me përbërje të lartë anëtarësh nuk pranonin të akomodoheshin të ndarë nga njëri-tjetri, për rrjedhojë qëndrimi i tyre u bë brenda këtyre ambienteve.

Lidhur me ankesën se mungojnë shërbimet bazë dhe janë detyruar të dalin jashtë Qendrës, u informuam se nga ora 07.00 – 22:00, shtetasit e regjistruar në këtë Qendër janë të lirë të lëvizin pa pasur pengesa. Njëkohësisht, institucioni gjatë periudhës së pandemisë COVID – 19, me qëllim parandalimin dhe mospërhapjen e infeksionit, ka mundësuar maska mbrojtëse doreza dhe dezinfektues me bazë alkooli. Gjithashtu, në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz, është bërë dezinfektimi i mjediseve të institucionit çdo muaj në mënyrë periodike, si dhe çdo herë pas largimit të grupeve. Po ashtu, në këtë Qendër nuk është shprehur asnjë shqetësim për shfaqjen e simptomave të COVID 19. Ndërsa Sektori i Mbështetjes së Azilkërkuesve, vlerëson nevojat bazë të personave, që do të akomodohen dhe më pas shoqërohen në ambientet e akomodimit. Duke u bazuar në udhëzimin nr.1547, datë 27.08.2009 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucione publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”, ku vlera e kuotës ditore është 330 lekë/personi. Gjithashtu, kuota ditore ushqimore ka mbetur e pandryshuar dhe vazhdon të jetë tejet e ulët dhe e pamjaftueshme duke mos iu përgjigjur nevojave normale për ushqim. Përcaktimi i normativave të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve është tepër e rëndësishme pasi grup moshat e paraqitura në qendër janë të moshave të ndryshme, të cilët jo rrallëherë paraqiten në kushte jo të mira fizike.

Ndërkohë, institucioni ka bërë shpërndarjen të detergjenteve apo materialeve të ndryshme për përdorim vetjak sipas planit të shpërndarjes dhe bazuar në kërkesat e azilkërkuesve. Në mënyrë periodike në Qendër bëhet dezinfektimi i ambienteve të përbashkëta në mensë, bibliotekë, sallë interneti, sallë lojra për fëmijë, territorin e qendrës, si dhe pastrimi dhe higjienizimi i gjithë territorit të Qendrës.

Për sa i përket pretendimit të ngritur në media nga azilkërkuesit, se atyre nuk iu është bërë tamponi për COVID-19, nuk na u dha ndonjë informacion. Gjithsesi Avokati i Popullit vlerëson se testimi ndaj Covid-19, bëhet në rast të pasjes së simptomave.

Për të marrë më shumë informacion lidhur me këtë problematikë ne ju drejtuam me shkresën nr. K4/1 17-3 prot, datë 06.04.2021 Qendrës Kombëtare të Pritjes për Azilkërkuesit, Babrru Tiranë. Konkretisht, kërkuam nëse gjatë kësaj periudhe janë mbajtur procesverbale nga punonjësit e saj lidhur me rastet e refuzimit të anëtarëve të familjeve me shumë persona për tu ndarë në dhoma banimi me qëllim krijimin e kushteve

të banimit më të mira për ta. Gjithashtu kërkuam nëse dispononin dokumentacion lidhur me këtë çështje, si kërkesa/deklarata të nënshkruara nga familjarët madhorë, ku të konfirmojnë se ata dëshironin të qëndronin në një dhomë, pavarësisht se sipas rregullave të Qendrës, akomodimit i një familje në një apartament në institucion parashikohet të jetë për 3 deri 4 persona dhe jo për më shumë persona.

Në përgjigje të shkresës tonë, QKPA me shkresë numër 96/1 prot, datë 31.05.2021 ndërmjet të tjerash na informoi se Qendra, disponon apartamente ku mund të strehojnë familje me numër të madh personash. Në momentin e mbërritjes në Qendër punonjësi i sektorit të Mbështetjes së Azilkërkuesve i njeh me të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve.

Ndërsa lidhur me kërkesën tonë për dokumentacionin e përshkruar më sipër, nuk u informuam. Kjo të le të kuptosh se dokumentacioni lidhur me këtë problematikë nuk është mbajtur e administruar nga ana e kësaj Qendre. Kjo krijon dyshime lidhur me mirëadministrimin e veprimtarisë së kësaj Qendre, si dhe respektimin e të drejtave të azilkërkuesve. Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit nga kjo Qendër është e rëndësishme dhe e domosdoshme. Rëndësia e tyre rritet në rastet kur krijohen shqetësime lidhur me respektimin e të drejtave të banorëve të saj. Për krijuar besueshmëri në përgjigjet e dërguara institucioneve të administratës publike, por edhe atyre institucioneve kushtetuese të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, informacioni për problematika të caktuara duhet shoqëruar me dokumenta shtesë, të cilat provojnë përmbushjen e detyrimeve institucionale ndaj shtetasve të ndryshem. Në rastin në fjalë, kur kemi të bëjmë me shtetas të huaj, të cilët janë në nevojë dhe mund të kenë kaluar trauma të ndryshme psikosociale dhe që nuk njohin gjuhën e vendit, rëndësia e këtij procesi shtohet. Gjithashtu, situata në të cilën ndodhemi për shkak të COVID-19 kërkon nevojën e një kujdesi më të madh social, shëndetësor dhe akomodues ndaj kësaj kategorie.

Ju sjellim në vëmendje se Avokati i Popullit vlerëson se mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të shtetasve të huaj që ndodhen në territorin shqiptar nga administrata publike është pjesë e misionit ligjor të tij. Në këtë kuadër çmojmë se akomodimi në një dhomë të familjeve të azilkërkuesve me shumë anëtarë, përbën çënim të së drejtës së çdo personi për banim sipas standardeve ndërkombëtare dhe ato kombëtare të përcaktuar në ligjin nr.10/2021 datë 01.02.2021, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.²

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikes 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*.”

² Neni 56 i ligjit nr.10/2021, “E drejta për kushtet minimale të jetesës dhe kushte sociale”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për shfuqizimin të udhëzimit nr.1547, datë 27.08.2009 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”, në lidhje me rritjen e kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të shportës së ushqimeve si dhe vlerësimin e tyre vit pas viti.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e fondeve të nevojshme për përmirësimin e kushteve të jetesës së azilkërkuesve të strehuar në Qendrën Kombëtare të Pritjes për Azilkërkuesit, Babrru Tiranë, me qëllim garantimin e hapësirës së nevojshme për çdo person, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare.
3. Marrjen e masave të nevojshme për mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit përkatës, nëpërmjet procesverbaleve, në të gjitha ato raste kur kryefamiljarët e familjeve të azilkërkuesve, nuk pranojnë ndarjen e pjesëtarëve të tyre në dhoma më vete.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

ERMONELA XHAFA